



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46000
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

DATA/DATUM/DATE	11.04.2025
NR/BR.	01.Nr. 86/25
PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Xhavit Zariqi – Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	z. Agim Aliu – Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit 01. Nr. 147 datë 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), nenit 40 shkronja (l) dhe nenit 58 pika 1. h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenin 4, nenet 44, 45, 46, të Ligjit Nr. 05/L -031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.815/2023 i datës 23.01.2025, Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës, paraqet këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për shfuqizimin e Vendimit 01.Nr. 147 të datës 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt.

Shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit Komunal të Ferizajt Nr. 147 i datës 25.09.2017 me të cilin është miratuar Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), për shkak se vendimi është bazuar në një pëlqim të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, i cili është shfuqizuar nga Gjykata e Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative sipas Aktgjykimit A.nr.2093/2019 i datës 12.09.2023 i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.815/2023 i datës 23.01.2025.

Arsyetim

Vendimi i lartcekur i Kuvendit Komunal është marr në bazë të një pëlqimi të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor nr. prot 4329-2/17 i datës 04.09.2017, i cili, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 2039/2019 i datës 12.09.2023 i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr. 815/2023 i datës 23.01.2025, i zëvendësuar si në dispozitiv të aktgjykimit. Ky pëlqim përbënte kusht formal dhe paraprak për procedimin dhe miratimin e PZHK-së në Kuvend.

Bazuar në këtë, vazhdimi i efektit të vendimit të Kuvendit do të ishte në kundërshtim me aktgjykimin e formës së prerë dhe me parimet e ligjshmërisë. Komuna është e detyruar të harmonizojë aktet e saj me aktet gjyqësore dhe legjislacionin në fuqi.

Në përputhje me Ligjin e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit dhe e Mjedisit obligohet që të filloj procedurat ligjore për hartimin e dokumentit të ri të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Ferizajt.

Me respekt,